



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Nr 01-11262 12863

Datë: 14.08.2024

Kryetari i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 13 dhe nenin 58 pika (b) të Ligjit numër 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 35 të Ligjit numër 08/L-197 për Zyrtarët Publik, me qëllim të mbarëvajtjes së punëve në Sektorin për Hapësira Publike, me datë 14.08.2024 mori këtë:

V E N D I M

1. Nëpunësi **Pjeter Frrokaj**, i sistemuar në punë Zyrtar për Hapësira Publike në kuadër të Drejtorisë për Shërbime Publike, **caktohet ushtrues i detyrës së Udhëheqësit të Sektorit për Hapësira Publike**, që të punoj me kompetenca të plota, sipas koeficientit **7.26 (GJ3)** duke filluar nga data **02.09.2024**.
2. I emëruari si në piken 1 të këtij vendimi, ushtron detyrat dhe përgjegjësitë si më poshtë:
 - 2.1. Udhëheqë punën e gjithmbarshme të sektorit dhe ndihmon mbikëqyrësin në caktimin e objektivave dhe hartimin e planit të punës për përmbushjen e këtyre objektivave.
 - 2.2. Menaxhon me stafin e sektorit dhe bënë ndarjen e detyrave tek varësit e tij, ofron udhëzime dhe monitoron punën e stafit për të siguruar produkte dhe shërbime cilësore.
 - 2.3. Ndihmon mbikëqyrësin në vlerësimin e proceseve dhe procedurave të brendshme dhe rekomandon ndryshime/përmirësime me qëllim të ngritjes së efikasitetit në punë.
 - 2.4. Kontribuon në procesin e vendimmarrjes, sipas fushës së përgjegjësi duke siguruar të dhëna të detajuara dhe analiza të cilat mbështesin procesin e vendimmarrjes.
 - 2.5. Siguron koordinimin e aktiviteteve me njësitë e tjera organizative të Komunës së Gjakovës për të siguruar efikasitet dhe zbatim të drejtë të proceseve të punës.
 - 2.6. Bën vlerësim të rregullt të stafit nën mbikëqyrje të tij dhe përkrahë zhvillimin e tyre përmes trajnimeve për të siguruar kryerjen e detyrave të tyre në nivel me standardet e kërkuara.
3. Zyrтари publik nuk mund të caktohet si ushtrues detyre më gjatë se gjashtë (6) muaj. Kur pozita nuk mund të plotësohet brenda afatit gjashtë (6) muaj, ky afat mund të zgjas më së shumti edhe për gjashtë (6) muaj të tjerë. Pozita e lirë nuk mund të zëvendësohet me ushtrues detyre për më gjatë se afati i përcaktuar. Çdo vendim i marrë nga ushtruesi i detyrës pas kalimit të afatit të përcaktuar është i paligjshëm.
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Vendimi iu dorëzohet:

- Nëpunësit Pjeter Frrokaj
- Drejtorisë për Shërbime Publike
- Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore
- Arkivit

Ardian Gjini

Kryetar i Komunës së Gjakovës